



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

THIRRJE PËR POZICION TË LIRË PUNE

Pozicioni: Specialist (Pilot) në Sektorin e Operimeve në Fluturim, në Drejtorinë e Standardeve të Fluturimit.

1. Çfarë po kërkojmë ne?

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për qëllim rekrutimin e profesionistëve të fushës, bazuar në profesionalizëm dhe meritë.

Në këtë thirrje Autoriteti i Aviacionit Civil kërkon të rekrutojë profesionistë të fushës, me eksperiencë në administratën publike ose/dhe sektorin privat.

2. Detyrat e pozicionit të punës:

- a) Kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme për të asistuar Përgjegjësin e OPS për Zbatimin në Shqipëri të SARPS-ve përkatëse të përfshira në Aneksin 6, Aneksin 9, Aneksin 18, dhe Aneksin 19 të ICAO-s si edhe kryen përditësimet e nevojshme;
- b) Përgatit mjetet e nevojshme për mbikëqyrjen efikase dhe efektive të operatorëve të transportit ajror përkatësisht manualin e inspektorëve, listat e kontrollit, formularët e anketimit dhe forma e auditit dhe i bëjnë ato lehtësisht të disponueshme në sektor. Kjo duhet të përfshijë mjetet për inspektime efikase dhe certifikim fillestar të operatorëve ajror, mbikëqyrjen vjetore të vazhdueshme dhe inspektimet në fluturim;
- c) Rishikon të gjithë manualat, procedurat e shkruara dhe manualin e lëshuar nga DFS në lidhje me sigurinë në operim dhe përditëson sipas nevojave;
- d) Mbështet Përgjegjësin e Sektorit të Operimeve në Fluturim (OPS) në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të autorizuar/deklaruar, certifikuar Operatorët e Transportit Ajror në përputhje me rregulloret e aplikueshme, procedurat e shkruara dhe direktivat e tjera përkatëse të lëshuara nga AAC;
- e) Mbështet Përgjegjësin e Sektorit të Operimeve në Fluturim me veprimet e nevojshme për të lëshuar, rinovuar, ndryshuar, pezulluar ose anuluar certifikatat/autorizimet, deklaratimet e Operatorëve të Transportit Ajror të miratuara sipas rastit;
- f) Siguron mbikëqyrje të vazhdueshme për operatorët e certifikuar/autorizuar, deklaruar të transportit ajror në mënyrë që të sigurohet që ata të ruajnë standardet e kërkuara të sigurisë në operim të specifikuar nga ACAA;
- g) Kryen inspektime në fluturim, në lidhje me kabinën e pilotit;
- h) Merr masat e nevojshme për vendosjen e standardeve të sigurisë në operim në Shqipëri (sipas kërkesave të ICAO/EASA).

3. Kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës që duhet të plotësojë kandidati

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të zotërojë gjuhën shqipe dhe angleze, të shkruar dhe të folur;
- c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- e) Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna nga institucionet publike apo private, ku ka ushtruar profesionin, e cila nuk është shuar sipas legjislacionit përkatës.

Kërkesat e pozicionit të punës:

- a) **Licencë:** Të ketë ose të ketë patur Licencë Piloti Komercial (CPL).
- b) **Eksperiencia në punë:** Të paktën 5 vite përvojë pune në agjenci në lidhje me mbikëqyrjen e sigurisë së aviacionit dhe përvojë në mbikëqyrjen e sigurisë së operimeve të fluturimit ose të ketë qenë pilot komercial me jo më pak se 1500 orë fluturimi ose ka qenë pilot i avionëve me krahë fiks me të paktën 250 orë fluturimi dhe të plotësojë 2 vite përvojë pune në Mbikëqyrjen e Sigurisë, deri në momentin e lëshimit të autorizimit fillestar si Inspektor.
- c) **Gjuhë e huaj:** Anglisht Niveli B2 (ose ekuivalente).

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti;
- b) Formën e aplikimit të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti;
- c) Fotokopje e Licencës së Piloti Komercial (CPL).
- d) Fotokopje e librezës së punës;
- e) Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- g) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

5. Aftësi të kërkuara:

- a. **Etika dhe vlerat:** Të demonstrojë integritet, profesionalizëm dhe konfidencialitet. Të veprojë në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me vlerat themelore të institucionit;
- b. **Komunikimi:** Përcjell, merr dhe kupton në mënyrë efektive informacionin në mënyrë verbale apo të shkruar;
- c. **Zgjidhja e problemeve:** Zgjidh çështje të niveleve të ndryshme të kompleksitetit, paqartësisë dhe rrezikut brenda funksionit përkatës. Merr vendime në kohë duke marrë parasysh faktet, detyrat, qëllimet, kufizimet, rreziqet dhe pikëpamjet kontradiktore përkatëse;
- d. **Iniciativa:** Identifikon dhe trajton çështjet në mënyrë të pavarur, proaktive dhe këmbëngulëse për të arritur objektivat;
- e. **Aftësitë Teknike:** Zbaton dhe përmirëson njohuritë dhe aftësitë teknike për të kryer detyrat e ngarkuara.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për edukimin, përvojën, trajnimet apo kualifikimet, si dhe njohuritë e lidhura me fushën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

- Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është **40 pikë**;
- Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është **60 pikë**.

Kandidati me rezultatet më të larta (por jo më pak se 70 pikë) shpallet fitues, ndërsa kandidatët që marrin të paktën 70 pikë në vlerësimin e përgjithshëm renditen në listë pritje.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

REZULTATET E VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT

Rezultate e vleresimit të dokumentacionit.

Në datën **25/06/2025**, Autoriteti i Aviacionit Civil do të shpall një faqen e tij zyrtare të internetit, listën e kandidatëve të kualifikuar për intervistë, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës, si dhe vendin dhe datën e zhvillimit të intervistës.

Kandidatët të cilët nuk janë kualifikuar për intervistë mund të kërkojnë informacion me e-mail në adresën zyrtare rekrutime@acaa.gov.al, për aryet e moskualifikimit.

Shpallja e rezultatve të konkurimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve (vlerësimi i dokumentacionit dhe intervistës me gojë), Autoriteti i Aviacionit Civil, do të njoftojë individualisht me e-mail çdo kandidat për rezultatin e pikëve.

Kandidatët të cilët nuk janë dakort me rezultatin, kanë të drejtë të paraqesin ankim me e-mail pranë Autoritetit në adresën zyrtare rekrutime@acaa.gov.al. Afati i ankimit është **5 ditë** kalendarike nga data e njoftimit individual.

Autoriteti pas përfundimit të afatit të ankimit do të shpallë fituesin në faqen e tij të internetit.

APLIKIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT

Nëse mendoni se plotësoni kriteret e mësipërme Autoriteti i Aviacionit Civil ju fton të aplikoni dhe të dorëzoni dokumentat e kërkuara (të skanuara) në adresën zyrtare rekrutime@acaa.gov.al.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë në shqyrtim dhe do të njoftojë për intervistë vetëm kandidatët të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës, si dhe kanë dorëzuar brenda afatit të caktuar për aplikim dokumentacionin e plotë të kërkuar.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 22/06/2025.